



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:161465  
Datë: 26.11.2024  
Numri i dokumentit: 06505701

**C-III-17-0102**

*Paditësit:*

**1B K, 2.Xh H K, 3.A D 4.M K, 5.M F 6.R Sh , 7.M J 8.N L 9.N B 10.J Sh 11.S P 12.Sh G 13.Sh K 14.T A 15.V G 16.T Zh 17.D D, 18.E P 19. S Sh 20.K S V, 21. R K, 2I A, 23. M A 24. H P J 25. E K 26. F B 27. F K 28.F T, 29.F K 30. H D 31.M B 32.A Zh 33.A K 34. A D 35.A Z 36.M D 37.D V 38B N 39.V H dhe 40. H N ish punëtorë të N.Sh.”Marketing “  
*Përfaqësuar nga av.B I, Prishtinë.***

**Kundër:**

*E paditur:*

**1.Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha, nr.55, Lakrishtë -Prishtinë.  
**2.Autoriteti i Likuidimit NSh ”Metal Holding “ - Janjevë** (emrat alternativë- **SOE Metalac Janjevë dhe DD Metalac Janjevë.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Hajrie Shala gjyqtare kryesuese, Gazmend Sylaj dhe Djellza Hoxha gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me dt.25 nëntor 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. Refuzohet si e pabazuar padia e paditësve 1B K, 2.Xh H K, 3.A D 4.M K, 5.M F 6 R Sh , 7.M J 8.N L 9.N B 10.J Sh 11.S P 12.Sh G 13.Sh K 14.T A 15.V G 16.T Zh 17.D D, 18.E P 19. S Sh 20.K S V, 21. R K, 22 A, 23. M A 24.H P J 25. E K 26. F B 27.F K 28.F T, 29.F K 30. H D 31.M B 32.A Zh 33.A K 34. A D 35.A Z 36.M D 37.D V 38 B N 39.V H dhe 40. H N të cilët kanë interesit pronësor në asetet e të paditurave për katet 5,6,7,dhe 8 të ish Ndërtesës së bankës së Lubjanës dhe të **Obligohet Bordi i Drejtorëve të AKP:****

**I.1.** Të ndryshoj SDR – in e ish NSh “ Metallac– Metal Holding” me nr. SDR 0712A të dt. 14.07.2005, duke anuluar shënimin e dt. 23.03.1993, me nr. A1.3.2 nga rubrika e këtij SDR me shifër A1.3 lidhur me asetet e kësaj ndërmarrjeje – 4 katet ( kati 5,6,7 dhe 8) të objektit të ish Bankës së Lubjanës me sipërfaqe 0,90.90ha si dhe

**I.2.** Të ndryshoj SDR-in e ish NSh “Marketing” me nr. Ref. SDR 019-PRN097 të dt. 03.03.2010 dhe të përfshijë këta emra alternativ Organizata e Përbërë e Punës së Bashkuar OPPB “ Investmetali” ndërrarja amë, organizata punuese “ Investmetali – Banka”, Organizata punuese “Investmetali – Injeniering” dhe Organizata punuese “ Investmetali marketing” ku kjo e fundit ishte krijuar me bashkminin e organizatës punuese “ M E I” dhe organizatës punuese OP “ I” duke përfshirë në SDR-in e plotësuar përshkrimin e saktë të aseteve – 4 katet ( katet 5,6,7 dhe 8) te objektit te ish “Bankës se Lubjanës” në sip. Prej 1918 m2 neto sipërfaqe dhe pjesën proporcionale të sipërfaqes së trollit të ngastrës nr.. me sip. 0,90.90ha dhe

**I.3.** Të detyrohet AKP-ja që përfaqësuesit të paditësve të ja njoh shpenzimet e përfaqësimit sipas tarifës së OAK-së, për padi kur vlera e kontestit është mbi 100.000 euro – 650 euro, për dy seanca nga 845 euro, gjithsejtë 2,340 euro dhe për taksë gjyqësore 100 euro.

## **II. Nuk caktohen taksat gjyqësore për paditësit .**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt.05 maj 2017, përfaqësuesi i paditësve, parashtrori në Dhomën e Posaçme padi/ankesë kundër Njoftimit të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) të N.Sh Banka e Lubjanës për papranueshmërinë e Dëshmisë së interesit nr.4983 të dt.16 03.2017. Me këtë kërkesë kishte kërkuar nga Autoriteti i Likuidimit të NSH “Banka e Lubjanës“ që të njoh interesin pronësor të punëtorëve të ish NSH “Marketing” për të hyrat nga shpronësimi – privatizimi i objektit të kësaj banke sepse, me Vendimin mbi shpronësimin të marr nga Qeveria e Kosovës, vetëm AL i Bankës së Lubjanës është përcaktuar si pronare e vetme edhe pse NSH “Marketing” e ka gjithë dokumentacionin pronësor për pronësinë e kësaj ndërtese. Me dt.05.04.2017, AL i NSH ”Banka e Lubjanës” ka refuzuar kërkesat e paditësve me anë të njoftimit për pa pranueshmërinë e dëshmisë së interesit nr.4981 të cilin përfaqësuesi e kishte pranuar me dt.07.05.2017. Kurse, me dt.23.03.2016 Qeverisa e RKS kishte nxjerrë Vendimin nr.01/81 dt.23.03.2016 dhe Vendimin preliminar nr.01/90 dt.01.06.2016 me të cilin e ka miratuar shqyrtimin e mëtutjeshëm për shpronësimin e parc.kad.nr.. në të cilën ngastër gjenden dy objekte O-.. si dhe O-., ku si pronar i vetëm është cekur Banka Themelore e Bankës së Lubjanës në Prishtinë.

Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur këto prova:

- Aktvendimi AC-I.-22-0645-A0001 i DHPGJS,
- Kontrata e shitblerjes për hapësirën e biznesit nr.. dt..,
- Aneksi për transferimin e fondeve të shoqërisë me taksë që përfshihen në kontratën nr.. dt..,
- Kontrata e qirasë lidhur në mes të NSH Metalac Janjevë si qiradhënës dhe OSBE –së si qiramarrës e dt..
- Njoftimi i për Likuidim të ndërmarrjes i Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit dt.15.01.2007.
- Vendimi nr.01/81 dt.23.03.2016,
- Vendimi preliminar nr.01/90 dt.01.06.2016,
- Ankesë kundër vendimit preliminar për shpronësim nr.373/07/16 dt.15.07.2016,
- Kopjet e Njoftimeve për secilin ankues, për papranueshmërinë e Dëshmime të Interesit .

Me dt.18 korrik 2017, e paditura ka paraqitur mbrojtje në padi ku ka pohuar se e kundërshton padinë e paditësve pasi që e njëjta është e pa bazuar në ligj. Ka shtuar se paditësit nuk e kanë

theksuar bazën juridike të padisë, të njëjtit në procedurën e likuidimit të ndërmarrjes kanë paraqitur kërkesat e tyre kreditore, pastaj se Ndërmarrja është e regjistruar si NSH dhe jo si Shoqëri Aksionare siç kanë pretenduar ankuesit. Tutje ka shtuar se AKP-ja është administruese e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore dhe vetëm ajo ka të drejtë të kërkojë të drejta mbi ndërmarrjet shoqërore. Ndërsa, sa i përket pretendimeve të paraqitura në padi ka gjetur se, nuk janë të mbështetura në fakte dhe prova.

Me dt. 07.06.2022 përfaqësuesi i paditësve – propozuesve ka ushtruar parashtresë me të cilën ka plotësuar padinë në aspektin subjektiv andaj, nën pikën 2 si të paditur ka përfshirë AKP-në – Autoritetin e Likuidimit NSH “Metal Holding” - Janjevë me emra alternative SOE Metalac Janjevë, me nr. Fi-739/89 të dt.11.01.1990 dhe DD Metalac Janjevo, me nr.Fi-6254/92 të dt.31.12.1992 (në likuidim) të përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe të krijuara në kohën e masave të dhunshme të Serbisë, në Ekonominë e Kosovës dhe atë pas suprimimit të Kuvendit të Kosovës me dt. 23 mars 1989, të cilat ndryshime nuk i njeh Ligji i AKP-së siç i ka njohur gjykata. Në mbështetje të parashtresës përfaqësuesi ka bashkangjitur

- Njoftimin për Likuidim të AKP-së, kontratën mbi qiranë të dt.26.11.1988 nr.73 e nënshkruar në emër të OSBE-së, nga R V D G dhe nga drejtori i Shoqërisë Aksionare (DD) Metallac, Al G, Kontratën për shitblerje të dt., Aneksin e kontratës të shitblerjes të dt.. e lidhur në mes të NSH Banka e Lubljanës dhe NSH Investmetal, -Kopja e kontratës për rregullimin e raporteve lidhur me shfrytëzimin e objektit zyrtar e dt. 30.12.1988 në mes të “Industriës së Bashkuar Metalike-Investmetali” dhe bankës së Lublanës- Banka Themelore në Prishtinë.

-Kopja e kontratës së qiramarrjes e dt. 25.11.1998 në mes të “DD Metalac- Janjevë” dhe Ogranizatës për siguri dhe bashkëpunim Evropian (OESB)

-Njoftimin për likuidim të NSH Metalac Janjevë i 15.01.2007

Certifikata e regjistrimit të biznesit nr., e dt.. dhe Certifikata e regjistrimit të biznesit nr.. e dt... Vendimi i dt. 24.10.1995 i lëshuar nga Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë , me të cilin është fshirë nga regjistri gjyqësor “IM Marketing” nga Prishtina.

Me datën 07.06.2022, përfaqësuesi i autorizuar ka ushtruar propozimin për masë të përkohshme të sigurimit duke i bashkangjitur provat mbështetëse të cilat janë evidentuar më lart dhe në Aktvendimin e kësaj gjykate të dt. 11 nëntor 2022 është refuzuar si e pa bazuar.

Sa i përket legjitimitetit të kontestuar nga e paditura për përfaqësuesin e paditësve gjykata e ka shqyrtuar para se të marr vendimin lidhur me masën e sigurisë si veprim paraprak në mënyrë që pastaj të vendoset edhe për meritat e padisë.

Me dt.21 dhjetor 2022, Kolegji i DHPGJ mori Aktvendim me të cilin ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për caktim të masës së sigurisë me aktvendimin e dt. 11 nëntor 2022.

Me dt.06 dhjetor 2023, i autorizuari i paditësve i është drejtuar gjykatës me parashtresë ku ka pohuar se Prokuroria Themelore në Prishtinë sipas kallximit penal të ushtruar nga përfaqësuesi i paditësve, ka zhvilluar një hetim kundër zyrtarëve të AKP lidhur me statusin e ish NSH “Metal Holding” të njëjtit i ka bashkangjitur Aktvendimin 2022:0047146 dt.17.11.2023.

Me dt.18 dhjetor 2023, e paditura ka parashtruar Kundërpërgjigje me të cilën thekson se lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të paditësit ndaj aktvendimit 2022:0047146 të dt. 17.11.2023, me të cilin Hedhet kallëzimi penal kundër zyrtarëve të AKP-së, si dhe zyrtarëve tjerë të institucioneve shtetërore, konsideron se pretendimet apo konkludimet e përfaqësuesve të paditësve janë të pabazuara dhe joprofesionale për faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me një aktvendim me të cilin është Hedhë Kallëzimi penal mbi bazën e parashkrimit, i cili është

aktvendim formal procedural me të cilin nuk është vendosur lidhur me çështjen kryesore apo merita. Mbi të gjitha nuk kemi një vendim përfundimtar që do të shpallte të kundërligjshëm veprimet e zyrtarëve të AKP-së. Në kundërpërgjigje theksohet se “Padiësi ka theksuar se është gjetur se SDR- i NSH “Metal Holding është i pa vlefshëm”. Andaj, nga pretendimi i përfaqësuesit të padiësve se lidhur me gjetjet dhe konstatimin se SDR-it për NSH “Metal Holding” këto supozime janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara për faktin se SDR-i është i vlefshëm, përderisa nuk është anuluar me ndonjë vendim të plotëfuqishëm të gjykatës apo organeve kompetente.

Me dt.09 shkurt 2024, gjykata ka lëshuar një urdhër për Prokurorinë Themelore në Prishtinë – Departamentin për Krime të Rënda – Prokurorin H B, përmes të cilit ka kërkuar që të bëjë dorëzimin e lëndës PP.I.nr.55K/2022 nr.smil 2022:0047146 dt.17.11.2023. Prokuroria Themelore i është përgjigjur gjykatës duke bërë dorëzimin e gjithë dokumentacionit dhe vendimin për gjetjen lidhur me rastin e inicuar.

Gjykata në seancën e dt.26.01.2024, e ka obliguar të paditurën AKP që të bëjë dorëzimin e raportit SDR, të NSH-ve kontestuese “Invesmetal”, “Metal Holding”, “Investmetali – Marketing”, “Banka Interne” si dhe “Inxhiniering”. AKP i është përgjigjur këtij obligimi me dt.08 shkurt 2024.

Duke vepruar sipas kësaj lënde kjo gjykatë ka caktuar dhe ka mbajtur seancat si ate dëgjimore ashtu edhe shqyrtimin gjyqësor, ku kanë prezantuar të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse.

Si në seanca gjyqësore ashtu edhe në fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim i autorizuari i padiësve, gjykatës i ka kërkuar që të njoh të drejtën e padiësve si palë me interes në procedurën e shpronësimit të katër kateve të ndërtesës së ish “Bankës së Lubjanës” tani rr. “..” në Prishtinë. Aktvendimi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë me nr. PP.I.nr.55K/2022 dhe me nr.Smil 2022:0047146 i dt. 17.11.2023 me numër të dokumentit 02795191 i cili vendim është i plotëfuqishëm, i njëjti është shumë i qartë. Andaj, si palë padiëse konsiderojnë se është fjala për një rast jashtëzakonisht të thjeshtë pas Aktvendimit të marrur dhe gjykatës i propozojnë që të urdhëroj të paditurën që të anulohet raportin e përcaktimit të statusit të ish NSH “Metal Holding” i cili është nxjerrë me vepra penale të falsifikuara dhe keqpërdorime të detyrës zyrtare e poashtu që të ri shqyrtohet raportin mbi statusin e ndërmarrjes “Marketing” me qëllim që pronat t’i kthehen pronarit të vërtetë e t’i merren uzurpatorit dhe kryesve të veprave penale. Poashtu, i propozoi Gjykatës të njoh dhe të vërtetoj interesin pronësor të padiësve si ish punëtorë të ish NSH “Marketing” dhe nga kjo bazë ata të mund të përfitojnë nga lista e punëtorëve të 20%-shit. Përveq, tjerash ka theksuar se nuk e konteston vendimin e qeverisë lidhur me shpronësimin, kontesti i vetëm është rreth shumës së mjeteve të 20% të cilat do të duhet tu takonin padiësve. Vendimi i qeverisë ka të bëjë me komplet objektin e ish “Banka e Lubjanës” në kuadër të së cilës gjenden 4 katet e ish NSH “Marketing”.

Përfaqësuesi i padiësve bëri plotësimin dhe precizimin e padisë në kuptimin që përpos vërtetimit të interesit juridik dhe pronësor të padiësve gjykata do të duhej të lejonte anulimin e raporteve mbi statusin e këtyre ndërmarrjeve: “Metal Holdingut” me nr. SDR 712A, të dt. 11.07.2005, raportin mbi statusin SDR të marketing me nr. SDR 0190, SDR e ish “Investmetalit Marketing” me nr. Ref.SDR 0190 PRN 097 të dt. 03.03.2010 dhe raportin të ish NSH “Banka e Lubljanës” me nr. KPS 1374 lidhur me statusin e ish Ndërmarrjes Banka Kreditore në Prishtinë dhe ish Banka e Lubjanës për faktin se sipas interpretimit të tyre interesi pronësor në ngastrat e shpronësuara është përfshirë pjesërisht apo plotësisht në raportet e këtyre ndërmarrjeve. Në vazhdim lidhur me dosjen e prokurorisë për krime të rënda e luti gjykatën që t’ia lejoj të citoi konkluzionin, respektivisht deklaratën e shefit të zyrës ligjore në AKM, A X, mbi bazën e të cilit citoi “ne i kemi gjet marrëveshjet, vendimet e organit të dhunshëm serb i cili kompaninë amë Investmetal dëshiron ta bëjë “bijë” të gjoja një ndërmarrje më emër “Metalac Holding” me qëllim të përvetësimit, vjedhjes, tjetërsimit të pronës legjitime të ish ndërmarrjeve që pas luftës u bashkuan në një ndërmarrje të vetme dhe u regjistruan në ARBK nën administrim të përkohshëm

të UNMIK - ut të cilin regjistrim për 15 vite nuk e ka kontestuar as AKM-ja e as AKP-ja, as punëtorët e as dikush tjetër madje as një subjekt me çfarëdo interesi të përbashkët”.

Ndërmarrjet që u bashkuan në ish NSH “Marketingu” të gjitha ishin të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi që ishte me 26.03.1999 të cilat i kanë prezantuar përmes përfaqësuesit të tyre, kontratat e vlefshme mbi blerjen e lokaleve afariste në ndërtesën e ish “Bankës së Lubljanës” dhe për habi as AKM dhe AKP kurrë nuk reagojnë në korrespondencën tonë mbi 15 vjeçare me qëllim që të sqarohen ose shqyrtohen kërkesa dhe dokumentacioni madje edhe me rastin e shpronësimit nga Qeveria e Kosovës, as organi i shpronësimit nuk tregojnë kurrfarë gatishmërie që të bëjë korrigjimet e nevojshme, por u vazhduan me dokumente jo të plotë dhe jo të vërteta prandaj edhe kemi arritur në këtë situatë kur janë dalë të gjitha këto ngatërresa juridike edhe pse gjendja faktike ka qenë e qartë që nga fillimi edhe sot është e qartë. Pra, është dashtë të kalojnë 22 vjet për të ardhur në këtë ditë që ndoshta të sqarohet dhe drejtësia të vendoset në vend. Siç dëshmojnë provat në shkresat e lëndës në të gjitha këto NSH të përfshira dhe raportet të cilat u cituan më sipër janë vendosur masat e dhunshme dhe ka filluar ofensiva e plaçkitjes së NSH-ve të Kosovës duke përjashtuar menaxhmentin dhe punëtorët shqiptar, e duke prodhuar dokumentacion të falsifikuar me qëllim të përvetësimit edhe individual.

Andaj, përfaqësuesi i paditësve ka kërkuar nga gjykata që të miratohet në tërësi padia e paditësve dhe të vërtetohet se të njëjtit kanë interes pronësor në asetet e shpronësuara në emër të të paditurave, për katet 5,6,7 dhe 8 të ish Ndërtesës së “Bankës së Lubljanës”, si dhe të Detyrohet Bordi i Drejtorëve të AKP-së që të ndryshoj SDR-in e ish NSH “Metalac” – “Metal Holding” me nr.SDR0712A dt.14.07.2005, duke anuluar shënimin e dt.23.03.1993, me nr.A1.2.3 nga rubrika e këtij SDR-i, me shifër A1.3 lidhur me asetet e kësaj ndërmarrjeje - 4 katet (katet 5,6,7 dhe 8 të Objektivit të ish “Bankës së Lubljanës” dhe pjesën proporcionale të sipërfaqes së trolit të ngastrës nr.6035 me sip.0.90.90 ha. Po ashtu të Detyrohet Bordi i Drejtorëve të AKP-së që të ndryshoj SDR-in e NSH “Marketing” me REF.SDR019-PRN097 dt.03.03.2010 dhe të përfshijë këta emra alternativ; Organizata e Përbërë e Punës së Bashkuar OPPB “Investmetali” ndërmarrja amë Organizata Punuese “Investmetali – Banka”, Organizata Punuese “Investmetali Ingeniering” dhe Organizata Punuese “Investmetali Marketing”, ku kjo e fundit ishte krijuar me bashkimin e Organizatës punuese “Market Export – Import” dhe Organizatës Punuese OP “Intermarket” duke përfshirë në SDR-in e plotësuar me përshkrimin e saktë të aseteve – 4 katet, katet 5,6,7 dhe 8, të Objektivit të ish “Bankës së Lubljanës” në sip.prej 1918.4 m2 dhe pjesën proporcionale të sipërfaqes së trolit të ngastrës nr. sip.0.90.90 ha. Në fund ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

***Përfaqësuesi i AKP-së ka deklaruar se*** kërkesëpadia e orientuar ndaj AL-së lidhur me kërkesën për njohjen e 20% -shit ku për rrjedhje AL-ja e Bankës së Lubjanës e ka refuzuar me njoftimin nr. protokollit 16433/2017, si kërkesë të pa pranueshme për faktin se si procese janë të ndara 20%-shi me kërkesat kreditore. Lidhur me Aktvendimin e prokurorisë e paditura konsideroi se janë deklaruar por për njoftimin e gjykatës për NSH “Metalaci” është vendosur SDR në vitin 2005, për “Marketingun” në vitin 2010, për Bankën e Lubjanës në vitin 2016. Më konkretisht për NSH “Metallacin” ka qenë në fuqi rregullorja 2002/13 e cila ka paraparë afatin 9 mujor të ankimimit të vendimeve kundër vendimeve të AKP-së edhe në këtë rast të NSH “Metallacit”, gjithashtu edhe me përcaktimin e statusit të NSH “Marketingut” ka qenë në fuqi ligji tjetër i Dhomës që ka paraparë të njëjtën dispozitë me afatin e ankimimit prej 9 muajve.

Tutje ka shtuar se kur bëhet fjalë për NSH “Metalac” dhe NSH “Investmetal” kemi të bëjmë me të njëjtën ndërmarrje duke ju referua SDR apo KPS, kronologjia ka të bëjë me të njëjtën NSH dhe për këtë ka bashkëngjitur dëshmitë se në vitin 1992 kanë pas një shkrirje. Kurse, sa i përket NSH “Marketingut” është si etnitet i veçantë dhe ani pse është në listë, problemi i ndarjes së mjeteve është se nuk janë përfshi si pronë e Marketingut por, në “Metal Holding”

Lidhur me kundërshtimin e vendimit për përcaktimin e statusit SDR Metalacit, është vendos në vitin 2005 ku ka qenë rregullorja 2002/12 ku është paraparë afati 9 mujor për kundërshtimin e

këtij vendimi. Ndërsa, për këto dy ndërmarrjet tjera janë paraparë me ligjin e AKP-së afatin 3 mujor. Konsiderojmë se kundërshtimet e tilla janë të jashtë afatshme dhe i propozojmë gjykatës që ta hedh padinë si të pa pranueshme. Gjithashtu lidhur me kallëzimin penal konsideroj se jemi deklaruar dhe mbesim pranë deklarimeve në parashtresë dhe të gjitha deklarimeve të mëparshme.

Kurse në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, ka deklaruar se sa i përket precizimit të cilin e ka bërë i autorizuari i paditësve, me të cilin ka kërkuar anulimin e raporteve për statusin e ndërmarrjeve, konform rregullores së UNMIKUT nr.2002/13, paditësi ka mund të depozitohet padinë brenda 9 muajve. Poashtu, edhe Ligji për DHPGJS-ë e parasheh afatin prej 120 ditësh. Prandaj, padia e paditësve duhet të hedhet poshtë si e pa pranueshme pasi që edhe kallëzimi penal është hedhur mbi bazën e parashkrimit dhe lidhur me këtë nuk ka një vendim që do të shpallte të kundërligjshme veprimet e zyrtare të AKP-së. Andaj, edhe pretendimi i përfaqësuesit të paditësve se lidhur me gjetjet dhe konstatimin se SDR-it të ndërmarrjes shoqërore "Metal Holding" është i pavlefshëm, janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara, për faktin se SDR-i është i vlefshëm, përderisa nuk është anuluar me ndonjë vendim të plotëfuqishëm të gjykatës, apo organeve kompetente. Pronësia mbi ndërtesën e ish "Banka e Lublanës" evidentohet në emër të "Banka e Lublanës-Banka Themelore" në Prishtinë dhe "Metal-Holding" (Metalac) me seli në Janjevë. Sipas kontratës nr. të dt. 01.. e lidhur ndërmjet BVI për qeverisjen me tokat ndërtimore në Prishtinë dhe "Banka e Lublanës-Banka Themelore në Prishtinë", i është dhënë në shfrytëzim "Bankës së Lubljanës – BTH" në Prishtinë, toka ndërtimore me kompensim me qëllim të ndërtimit të objektit të ri afarist.

Me Aktvendimin 08.nr.351-1090 të datës 01.07.1985 i lejohet investitorit "Banka e Lublanës", ndërtimi i objektit investues. Hapësirat e ndërtesës apo katet të cilave i referohen ish punëtorët e NSH "Marketingu" pra, katet VI, VII dhe VIII, në bazë të dokumenteve pronësore, evidentohen në pronësi të NSH "Metal Holding (Metalac)" me seli në Janjevë. Me vendimin 06 numër: 46-62/92 të datës 23.03.1993 i cili është nxjerrë nga Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike e Komunës së Prishtinës dhe është vërtetuar se Ndërmarrja Shoqërore "Metal Holding" (Metalac me seli në Janjevë), shfrytëzon dhe disponon me katet VI, VII dhe VIII-të të ndërtesës afariste ish "Banka e Lubjanës" në Prishtinë si dhe një pjesë të tokës e evidentuar si ngastra kadastrale nr.. me sipërfaqe prej 990m<sup>2</sup> në ZK Prishtinë, bazuar në kontratën e shitblerjes me nr.106 datë 04.12.1987 për hapësirat e lartpërmendura afariste, nënshkruar në mes të Ndërmarrjes së Përbërë të Punës së Bashkuar "Investmetali" në Prishtinë dhe ish "Banka e Lublanës-Banka Themelore" në Prishtinë. Sipërfaqja totale etazhore e hapësirave afariste nga kjo kontratë është: 1,800m<sup>2</sup> apo secili kat nga 600m<sup>2</sup>. Pronësinë mbi katin e V-të të ndërtesës në fjalë me sipërfaqe prej 479.60m<sup>2</sup>, Ndërmarrja e Përbërë e Punës së Bashkuar "Investmetali" e kishte fituar me datë 13.07.1988 në bazë të kontratës për bartjen apo transferimin e mjeteve me kompensim nga Kompania Sllovene DO SMELT, ndërmarrje për ndërtimin e objekteve industriale me seli në Lublanë si pronare e këtij kati sipas kontratës mbi ndërtimin e objektit të ndërtesës së re afariste të "Banka e Lubljanës" në Prishtinë me nr.. e nënshkruar me "Banka e Lublanës" me datë ..

Pastaj shtoi Vendimi 06 numër: 46-62/92 i datës 23.03.1993, ishte nxjerrë me kërkesë të NSH "Metal Holding" ("Metalac" në Janjevë) bazuar në: Vendimin nr. 01-300 të datës 24.04.1992 mbi bashkimin apo shkrirjen e Ndërmarrjes "Investmetali" në Ndërmarrjen Shoqërore "Metal-Holding/Metalac" nga Janjeva, sipas Marrëveshjes mbi Marrëdhëniet dhe rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet subjekteve nr.31 të datës 23.04.1992, përkatësisht nr.01-2096 të datës 25.04.1992; të vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me Fi-nr.1821/92 të datës 15.05.1992 mbi shlyerjen nga evidenca e ndërmarrjeve të Ndërmarrjes Industria për Përpunimin e Metaleve "Investmetali" nga Prishtina, për arsye të bashkimit me Ndërmarrjen Shoqërore "Metal Holding"-(Metalac) nga Janjeva. Andaj, kërkesëpadia është e pa themeltë pasi që faktet në të cilat mbështetet padia janë në kundërshtim me provat të cilat i kanë prezantuar paditësit.

Në fund, AKP-ja konsideron se pretendimet e paraqitura në padi, nuk janë të mbështetura me dëshmi dhe fakte materiale që do të ishin relevante për rastin konkret. Gjithashtu, padia dhe propozimet që dalin nga padia, nuk janë të mbështetura në asnjë dispozitë ligjore. Mungesat e tilla, padinë e bëjnë të paqëndrueshme dhe propozoi që kërkesëpadia e paditësve të hedhet ose të refuzohet si e pa bazuar.

### **Arsyetingimi Ligjor**

#### **Refuzohet si e pa bazuar padia e paditësve.**

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se “*pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)*”, ndërsa pika 3 parasheh se “*pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dëshon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.*”

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Dhoma e Posaçme Gjykatës Supreme, pas përfundimit të procedurës me shkrim bazuar në nenin, 40, lidhur me nenin 42 të Ligjit nr. 06/L-086, ka caktuar seancë dëgjimore publike, pastaj edhe seancë të shqyrtimit kryesor, në mënyrë që secilës palë përveç deklarimeve me shkrim tua mundësoj edhe deklarinimin me gojë, në kuptim të argumentimit të pretendimeve të tyre faktike dhe juridike që kanë të bëjnë me padinë .

Gjykata pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të lartëcekura dhe deklarimeve të palëve ndërgjyqëse, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në mes palëve në kontest, nuk ishte kontestues fakti se paditësit/ankuesit ishin punëtorë të NSH “Marketingut” të cilët mbi këtë bazë kërkonin t’ju njifet e drejta në të hyrat nga shpronësimi/privatizimi i cili është bërë me vendim të Qeverisë së Kosovës. Pra në Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 01/81 të dt. 23.03.2016 dhe në Vendimin preliminar nr. 01/90 të dt. 01.06 2016 është miratuar shqyrtimi për shpronësimin e pronës së palujtshme në ngastrën kadastrale P-.. në të cilën ishin të regjistruara në zyrën kadastrale dy objekte 0- .. dhe 0- .. dhe se me këtë vendim si pronare është cekur “Banka Themelore e Bankës së Lubjanës” në Prishtinë, por jo edhe Ndërmarrja Shoqërore “Marketing “ si pronare e kateve të objektit me nr. V,VI,VII dhe VIII, punëtorë të të cilës ishin këtu paditësit.

Poashtu, nuk është kontestues fakti se kontrata e shitblerjes për katin VI,VII dhe VIII e lidhur në mes Bankës së Lubjanës-banka themelore në Prishtinë si shitëse dhe “NSh Investametal” në

Prishtinë si blerëse, është e dt. 04.12.1987. Ndërsa, katin V të objektit –ndërtesës në sipërfaqe prej 479.60 m<sup>2</sup>, NPPB Investametal e kishte fituar pronësin në bazë të kontratës së dt. 22.02.1988 për bartjen apo transferin e mjeteve me kompenzim nga DO SMELT .

Me dt. 23.04.1992 është lidh marrveshtja për Mardhënje të ndërsjellta dhe shpërndarje të të drejtave dhe detyrimeve në mes të NSH “Metalac” Janjevë dhe NSH “Investmetal” Prishtinë.

Me dt. 24.04.1992 ishte marr vendim nga NSH Metalac –Janjevë, që kjo NSH ti bashkohet NSH “Marketingut” .

Pastaj Drejtoria për punë pronësore-juridike në Prishtinë me dt. 23.03.1993 ka marr vendim për njohjen e shfrytëzimit dhe disponimit të katit të VI,VII dhe VII të ndërtesës së ish Banka e Lubjanës në Prishtinë dhe një pjesë të tokës sipas parcelës kadastrale .. në sipërfaqe prej 990 m<sup>2</sup> në Prishtinë, sipas kontratës së dt. 04.12.1987 e cila kishte sipërfaqe prej 1.800m<sup>2</sup>

Ndërsa, me dt. 24.10.1995 me vendimin e Gjykatës Ekonomike në Prishtinë ishte fshirë nga regjistri i Gjykatës, NSH “Marketing” në Prishtinë. Andaj, kontestimi i paditësve dhe përfaqësuesit të tyre i referohet këtyre veprime të ndërmarrura të cilat konsideron se janë të kundërligjshme dhe që sollën deri te marrja në tërësi e lokaleve – katër kateve të objektit të ish Bankës së Lublanës, e për të përfunduar me regjistrimin e tyre në emër të NSH “Metalac” – Janjevë.

Mbi bazën e tyre përfaqësuesi i paditësve ushtroi kallxim penal pranë Prokurorisë Themelore – departamentit të krimeve të rënda - në Prishtinë për shkak të Veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 të KPRK-së dhe veprës penale falsifikim i Dokumenteve nga neni 390 të KPRK-së kundër zyrtarëve të Agjencionit Kosovar të Privatizimit. Prokurori i shtetit zhvilloi hetimet në drejtim të dy veprave penale dhe pas grumbullimit të provave të nevojshme mori vendim për hudhjen e kallëzimit penal për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit të ndjekjes penale në kuptim të nenit 84 pa.2 nënpar.2.3 të KPPRK-së .

Dhe duke u bazuar në të gjeturat e Prokurorisë së Shtetit nuk është kontestuese se transformimi i NSH –ve ishte bërë në kohën e masave të dhunshme dhe përcaktimi i statusit të NSH “Metal Holding” se është apo jo kjo ndërmarrje në pronësi shoqërore ishte vepruar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 për AKM me një procedurë të posaçme e pastaj, sipas dokumentacionit në dispozicion të SDR është konstatuar se “Metal Holding” është Ndërmarrje Shoqërore e të njëjtën ia ka paraqitur Bordit për Aprovim, veprime këto të marrura në korrik të vitit 2005 respektivisht në kohën e ish AKM-së. Ndërsa AKP- ja si pasardhëse e saj në kuptim të të Ligjit të AKP-së nr. 04/L-034/3 neni 30 par.3, ka marr përsipër të gjitha asetet dhe detyrimet të cilat ajo ose paraardhësja e saj i ka mbajtur. Ndërsa, sa i përket çertifikatës së UNMIK-ut nr. 8005003 e dt. 11.07.20000 ajo vërteton regjistrimin e biznesit të përkohshëm me emërtim N.SH.T. Marketingu. Ndërmarrja kishte vulën: Ndërmarrja Shoqërore për Tregti me shumicë dhe pakicë “Eksport-Import Marketingu“ megjithatë e njëjta nuk ishte aktive. Kjo për faktin se me Vendimin e Gjykatës Ekonomike në Prishtinë të dt. 24.10.1995 NSH marketingu ishte shlyer nga Regjistri gjyqësor dhe se ky vendim nuk mban vulë e as nënshkrim, nga kryetari i atëhershëm O T.



Mbi bazën e të cekurave më lartë Prokurori i Shtetit erdhi në përfundim se të gjitha këto prova ishin të sistemuara në SDR-in e Ndërmarrjes Shoqërore dhe ky Etnitet që nga themelimi ishte i organizuar si një Ndërmarrje Shoqërore e qeverisur mbi bazë të pronës shoqërore andaj në bazë të neit 51 të Ligjit të AKP-së Nr.03/1-067 kjo ndërmarrje bie nën jurisdikcionin e AKP-së .

Ndërsa, pas analizimit dhe shikimit të të gjitha veprimeve hetimore ka ardh në përfundim se vendimet e mundshme të kundërligjshme në përpilimin e SDR nr.0712A janë ndërmarr me dt. 11.07.2005 sa i përket përcaktimit –Determinimit të statusit juridik të NSH “Metal Holding” dhe si bazë e kësaj janë ndërmarr vendimet tjera pasuese si veprime inkriminuese që sipas ligjeve në fuqi janë parashkruar. Parashkrimi i ndjekjes penale ka arritur sepse nga korriku i vitit 2005 që merret si koha kur janë kryer veprat penale - veprimet e kundërligjshme në përpilimin e SDR-it, e deri më dt. 23.06.2022 nuk është ndërmarr asnjë veprim në drejtim të ndjekjes penale të veprave penale të kryera në korrik të vitit 2005, andaj për veprën penale Shpërdorim i Pozitës zyrtare ose Autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 sipas kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës kjo vepër penale ishte dënueshme me burgim prej 1 deri në 8 vite ndërsa vepra penale Falsifikim i dokumenteve zyrtare nga neni 348 par. 1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës e dënueshme me burgim prej 3 muaj deri 3 vite. Duke pas parasysh se kanë kaluar më tepër se 10 vite, në kuptim të nenit 90 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së është hudhë kallximin penale pasi që ka arrit afati i parashkrimit të ndjekjes penale.

Gjykata në këtë rast vlerësoi konstatimet dhe të gjeturat e Prokurorisë së Shtetit të cilat në një formë janë në pajtueshmëri me pretendimet të palës së paditur kur për paditësit ka deklaruar se nuk kanë respektuar afatet ligjore për kundërshtim të Raportit të SDR-it, gjë është paraparë me neni 6.1 të Rregullores UNMIK-ut 2002/12, pastaj me Ligjin e Dhomës së Posaçme nr. 06/L-086 si dhe me Ligjin e AKP-së nr.04/L-034.

Sipas të paditurës, në kuptim të Rregullores së UNMIK-ut neni 6.1, *paditësit kanë mundur të depozitojnë padinë për kundërshtimin e një vendimi ose një veprimi të Agjencisë brenda 9 (nëntë) muajve nga: a) data kur paditësi ka ditur ose po të kishte treguar kujdesin e duhur, ka qenë e arsyeshme të dijë për vendimin a veprimin e Agjencisë dhe b) data kur Dhoma e posaçme njofton publikisht se është në gjendje të pranoj padinë.*

*Ndërsa neni 18.2 i Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të privatizimit parashef se “Agjencia nuk është përgjegjëse për kurrfarë borxhi, veprimi ose mosveprimi që i atribuohet një ndërmarrje dhe asnjë ndërmarrje nuk është përgjegjëse për kurrfarë borgji veprimi ose mosveprimi që i atribuohet Agjencisë. Agjencia nuk është përgjegjëse për kurrfarë veprimi apo mosveprimi të drejtorëve, menagjerëve ose personave të tjerë kontrollues të ndërmarrjes nga Agjencia”.*

Mirëpo, për gjykatën në këtë rast mbeti i pa sqaruar fakti se paditësit a e kishin pranuar njoftimin, apo nëse kanë qenë në dijeni për SDR-in e NSH-së Marketingu, pasi që përfaqësuesi i paditësve e as paditësit asnjëherë nuk e kundërshtuan këtë rrethanë të cilën e paditura që nga fillimi ka kundërshtuar padinë e tyre mbi bazën e lëshimit të afateve ligjore.

Duke iu referuar këtyre dispozitave gjykata, vie në përfundim se pretendimet e përfaqësuesit të paditësve se AKM/AKP ka fshehur dokumentet dhe ka zbatuar vendimet e masave të dhunshme të shtetit okupues serb për ti privuar paditësit nga e drejta e tyre legjitime në pjesëmarrjen e tyre hyrave nga privatizimi i aseteve të ndërmarrjes së tyre, janë të pa argumentuara dhe pambështetura në ndonjë provë materiale .

Gjykata analizoi edhe pretendimet e të paditurës, sa i përket kohës së ushtrimit të mjeteve juridike si e drejtë e palës për të kundërshtuar për një mohim të së drejtës, e cila në mbrojtjen e saj ajo në vazhdimësi ka theksuar se paditësit nuk kanë shfrytëzuar të drejtën ligjore që në afatin prej 90 ditësh të ushtrojnë ankesën kundër SDR-it të cilën vetëm në gjykatë kërkuan anulimin e tij, andaj sipas vlerësimit të gjykatës ky pretendim i të paditurës ishte i bazuar.

Poashtu , Gjykata gjen se pretendimet e të paditurës janë edhe në lidhshmëri me Ligjin nr.06/L-086 i Dhomës së Posaçme sipas në nenit 10.1 i cili parashef se *“Pushteti dhe autoriteti i Dhomës së Posaçme për dhënjën e mjeteve tjera korrigjuese në lidhje me ndonjë Ndërmarrje, Korporat, Pasuri në pronësi apo posedim të një Ndërmarrje apo korporate apo ndonjë pasuri që më heret apo aktualisht është nën administrimin e AKM-së apo Ligjit mbi AKP-në i nënshtrohet kufizimeve kohore të përcaktuara me këtë nen”*

*Shtojca i ligjit nr.04/L-034 në neni 37.4 parashef “Kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marr pjesë në disbursimet nga likuidimi” si dhe neni 37.7 i shtojcës i cili parashef se “kreditore i prekur ka të drejtë të kërkoj nga gjykata brenda 30 ditëve pas dhënjës së njoftimit nga ana e AL-së që të vendos për kërkesën e tij dhe mos kërkitimi i tillë në kohë nga ana e kreditorit do ta pa mundësoj atë në kundërshtim të mëtejme të vendimit të AL-së “.*

Prandaj nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti heqë shpenzimet e veta të procedurës .

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Hajrie Shala, gjyqtare kryesuese** \_\_\_\_\_

**Gazmend Sylaj, gjyqtar** \_\_\_\_\_

**Diellza Hoxha, gjyqtare** \_\_\_\_\_